

E djelë 27 nëntor 2011

Nga ora 8.00 deri në orën 20.00 Fiera di Padova

VOTOHET

TË DREJTA NË KOMUNË

Komisioni për përfaqësimin e
Qytetarëve àdhe Qytetareve
të huaj rezidentë në Padova

Comune di Padova
Settore Gabinetto del Sindaco
U.P. Accoglienza e Immigrazione



Çfarë është: është një organizëm zyrtar perfaqësuesish të qytetarëve jo komunitarë dhe pa shtetësi që banojnë ligjërisht në Padova dhe jo me nënshtetësi italiane.

Funksioni: është një organ këshillimor për Kryetarin e Bashkisë dhe Juntën, Këshillin Komunal, Komisionet këshillore dhe Këshillet e Qarkut. Këtyre Komisioni mund ti paraqesë opinione mbi propozimet për aprovim dhe propozimet e veta mbi gjithçka që i përket jetës administrative të qytetit të Padovës.

Përbërja: është e përbërë nga 5 deri në 25 antarë të zgjedhur, të cilëve u shtohet Kryetari i Bashkisë (ose i deleguar i tij), një Këshilltar Bashkiak i shumicës dhe një i pakicës. Anëtarët e zgjedhur duhet të paraqesin të dyja gjinitë (meshkullore, femërore) të paktën 25% duhet të jënë të 4 nënshtetësive mbi 5 të këtyre zonave gjeografike: Afrika e Veriut dhe Lindja e Mesme, Afrika Subsahariana, Amerikat, Azia dhe Oqeania, Europa jo EU.

Roli: Presidenti/ja ose zëvendësi/ja e Komisionit merr pjesë në Këshillin Komunal me të drejtë fjale e pa të drejtë vote dhe paraqet propozimet e Komisionit. Komisioni nëpërmjet një antari të deleguar, merr pjesë edhe në Komisionet Këshillore dhe në Këshillet e Qarkut, me të drejtë fjale dhe pa të drejtë vote.



ZGJEDHJA

Kush voton: gjithë qytetarët e moshës për votim rezidentë të ligjshëm në Komunën e Padovës në datën e thirrjes së zgjedhjeve, me nënshtetësi jo komunitare ose pa shtetësi dhe pa nënshtetësi italiane.

Kush mund të zgjidhet: gjithë qytetarët e moshës për votim rezidentë të ligjshëm në Komunën e Padovës në datën e thirrjes së zgjedhjeve, me nënshtetësi jo komunitare ose pa shtetësi dhe pa nënshtetësi italiane.


Kur dhe ku votohet: të djelën më 27 nëntor 2011 nga ora 8.00 deri në oren 20.00 në Fiera di Padova.

Për kandidaturat: çdo kandidaturë duhet të jetë e nënshkruar nga 20 votues të ndryshëm (një zgjedhës mund të mbështesë vetëm një kandidat). Nënshkrimet duhet të jene të legalizuara nga nje zyrtar publik (edhe nga një Këshilltar bashkiak). **Kandidaturat duhet të paraqiten brënda datës 18 tetor 2011.**

Si votohet: kandidatët janë të radhitur në një skedë të vetme, sejcili me një simbol të caktuar nga Komisioni i Zgjedhjeve. Për shëmbull: □ Mario Rossi, Senegal (Afrika sub sahariane) □ Carla Bianchi, Cina (Azia e Oqeania)
Simboli identifikon kandidatin edhe per personat që nuk mund të lexojnë. Çdo zgjedhës mund shprehë ne maksimum një preferencë (një X mbi emrin ose mbi simbolin).

Kush është i zgjedhur: 10 zgjedhësit e pare janë më të votuarit nga sejcila prej 10 nënshtetësive me numer më të madh rezidentësh në Padova (Moldavia, Shqipëria, Ukraina, Maroku, Tunizia, Nigjeria, Filipine, Kina, Bangladesh, Sri Lanka). Të tjerët janë të zgjedhur mbi bazën e preferencave pavarësisht nga nënshtetësia, deri tek i 15. Në qoftë se janë respektuar kuotat e gjinisë dhe të përfaqësimit gjeografik Komisioni është i zgjedhur, në rast të kundërt do të integrohen deri në 25 anëtarë për të arritur kuotat e fiksuara.

Kuorumi: për të qënë zgjedhjet e vlefshme duhet të votojnë të paktën 15% e persona-ve me të drejtë vote (baraz rreth 2500 persona).



INFORMACIONE DHE KONTAKTE

Comune di Padova
Settore Gabinetto del Sindaco
Unità di Progetto Accoglienza e Immigrazione

telefon: 049 820 5091

mail: commissionestranieri@comune.padova.it



Comune
di Padova